



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 19/5 Prot.

Tiranë, më 23.01 2026

VENDIM

Nr. 04 Datë 23.01 2026

PËR

**“MIRATIMIN E FONDIT BUXHETOR PËR STUDENTËT QË PËRFITOJNË
MBËSHTETJE FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, SIPAS VKM
NR.386/2022, I NDRYSHUAR”**

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në nenin 11, dhe 112, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikën 3 dhe 6, të Vendimit nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, gjurmën “a”, “c” të pikës 2, pikën 6, 6/1 dhe 10, të Vendimit nr.386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në pikën 5, të Udhëzimit nr.30, datë 04.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit buxhetor për 184 studentë që përfitojnë mbështetje financiare , për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI

Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir BEJA

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI

Adresa: Rruga “Naïm Frashëri”, Nr.37, Tiranë, info.akfal@arsimi.gov.al